

**Roland Ilija**  
**Komisioner**

Diplomuar “Jurist” në vitin 1996 në Fakultetin Juridik, Universiteti i Shkodrës. Z. Ilija është licencuar në profesionin e avokatit në vitin 1997. Nga viti 2001 deri në 2002 ka kryer studimet master në Universitetin e Kolnit në Gjermani dhe ka marrë titullin “Magister Legum” (LLM). Pedagogu Roland Ilija ka kryer kërkime shkencore në disa universitete prestigjioze të Europës, si në Koln, Firence dhe në Universitetin e Grazit në Austri, në fushën e së drejtës kushtetuese dhe administrative, si dhe në të drejtën ndërkombëtare private. Më tej, gjatë karrierës së tij, z. Ilija ka zhvilluar vizita studimore në firma avokatie dhe në institucionet e Bashkimit European. Po ashtu, ai ka një eksperiencë të gjatë si lektor, që prej vitit 1996, në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër dhe në universitete të tjera jopublike. Nga viti 2004 deri në 2007, z. Ilija ka shërbyer si ekspert i projekteve rajonale në organizatën gjermane “GTZ”. Para se të emërohej nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në qershor 2017, Komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, z. Ilija mbante detyrën e zv.dekanit dhe shefit të departamentit të së drejtës civile në Fakultetin Juridik, Universiteti “Luigj Gurakuqi”. Komisioneri Ilija është njohës shumë i mirë gjuhëve të huaja anglisht, italisht dhe gjermanisht.